



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.192/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrijen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vodusur përkizazi me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega Gjakovë për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore në institucione publike, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 16.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e organizatës BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega Gjakovë, i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 2.000,00 (dymijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 11.10.2017, me të cilën pretendon se kandidati për kryetar të Komunës së Gjakovës nga subjekti politik AAK, Ardian Gjini duke i shfrytëzuar ndërmarrjet e zotëruara dhe të kontrolluara nga komuna e Gjakovës gjegjësisht KRM”Çabrati” me datën 10.10.2017 ka zhvilluar një takim publik me anëtarët e kësaj ndërmarrje. Parashtruesi i ankesës thekson se me këto veprime subjekti politik AAK ka shkelur nenin 35.1 të LZP-së

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotot e marra nga faqja publike e facebookut të AAK-së në Gjakovë ku pretendohet se ka ndodhur shkelja.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik AAK, të datës 12.10.2017, theksohet se vizita e kandidatit të tyre në KRM Çabrati është bërë me kërkesë të kësaj kompanie për tu njoftuar me problemin e mbeturinave në komunën e Gjakovës. I njëjti thekson se në qofte se ka ndodhur shkelja atëherë e njëjtë është bërë nga ana e kompanisë, dhe duke kërkuar nga PZAP-i që ankesa e bërë ndaj tyre të hudhet poshtë. Si dëshmi ka bashkangjitur ftesën e bërë nga punëtorët e ndërmarrjes në fjalë për ta vizituar këtë kompani.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografit e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Ardian Gjini, kandidat për Kryetar të Komunës së Gjakovës nga radhët e subjektit politik AAK, ka bërë fushatë zgjedhore duke e vizituar KRM Çabrati në Gjakovë, të cilën vizitë e ka publikuar në facebookut e subjektit politik AAK Gjakovë, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 35.1 të LZP-së që përcakton se *personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdore atë zyre ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje.*

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik AAK, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Si rrethanë, Paneli e mori edhe faktin që këtij subjekti politik, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre të njëjtit në arsyetimin e tyre theksojnë se vizita e realizuar është bërë me kërkesë të kësaj kompanie, e ku pretendimet e tillë nga ana e Panelit janë të vlerësuar si të paqëndrueshme pasi që dispozita ligjore e nenit 35.1 e LZP-së përcakton se *asnjë institucioni i administratës publike, ose edhe ndonjë ndërmarrje nuk mund të shfrytëzohen nga ndonjë subjek politik në zgjedhje.* Andaj Paneli gjeti se vizita e realizuar në KRM Çabrati në Gjakovë nga kandidati në fjalë ka karakter të fushatës zgjedhore të subjektit politik në fjalë.

Ndërsa lidhur me pretendimet e subjektit politik AAK se në qofte se ka ndodhur shkelja atëherë shkelja është bërë nga KRM Çabrati, Paneli thekson se Kodi i Mirësjelljes së Subjekteve Politike gjegjësisht neni 32.1 i LZP-së thekson se këtij kodi i detyrohen të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve politike dhe mbështetësit e tyre, andaj

mbi këtë bazë janë të paqëndrueshme këto pretendime të subjektit politik AAK që përgjegjësia të bie mbi kompaninë Çabrati.

Andaj bazuar në këtë kandidati në fjalë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjor duke bërë fushatë zgjedhore në objekte publike i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, me të cilën paneli vlerësoi se gjoba e shqiptuar do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Zl.Anr. 192/2017 më datën 16.10.2017.



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.